

## Bajrami: Projekti i mësimit në distancë po shënon sukseset e para

19:41 / 06.04.2020 Ministrja në detyrë e MASHTI-t, **Hykmete Bajrami**, ka folur rreth ecurisë së mësimit të distancë, në kohën kur Kosova po përballet dhe po lufton për çdo ditë për ta mposhtur **COVID-19**.

Ajo me këtë rast ka falënderuar nxënësit, studentët, prindërit, mësuesit, arsimtarët dhe profesorët e të gjitha niveleve për punën që po bëjnë për të realizuar në praktikë mësimin në distancë.

Postimi i plotë:

Nxënësit, studentët, prindërit, mësuesit, arsimtarët dhe profesorët e të gjitha niveleve meritojnë sot një duartrokitje dhe falënderim të madh për punën që kanë bërë për të realizuar në praktikë mësimin në distancë. Gjithë kjo punë vullnetare po bëhet në kohën kur Kosova po përballet dhe po lufton për çdo ditë për ta mposhtur **COVID-19**.

Prandaj, shfrytëzoj rastin edhe një herë të ju thërras të respektoni udhëzimet e institucioneve shëndetësore për r të qëndruar në **SHTËPI**.

Qëndrimin mbyllur brenda shtëpive dhe banesave po mundohem t'ua bëjmë më të lehtë përmes aktivizimit të fëmijëve tuaj në procesin mësimit.

Kemi filluar javën e tretë të mësimit në distancë. Falë punës së madhe të një ekipi të shkëlqyeshëm sot kemi qenë në gjendje që të transmetojmë 29 njësi mësimore për klasat 1 deri 9, kështu do të vazhdojmë edhe në ditët në vijim.

Por, projekti i mësimit në distancë nuk kufizohet vetëm në transmetimin e mësimit në **RTK**. Mësimi në distancë përfshinë të gjithë ata nxënës, studentë dhe mësime të cilat sot janë në komunikim në baza ditore.

Andaj në emër të MASHTI-it dhe timin personal dua të ju falënderoj gjithë ekipin që projektin e mësimit në distancë tanimë e ka kthyer në sukses.

Ekipi që po merret me prodhimet e video-xhirimeve përbëhet nga 120 mësime të cilat janë në komunikim në baza ditore nga **MASHTI**, **DKA** e Prishtinë s dhe Prizrenit që janë angazhuar drejtpërdrejt në përgatitjen e materialit mësimit virtual duke punuar çdo ditë në shkollën "Qamil Batalli" në Prishtinë dhe në shkollën "Emin Duraku" në Prizren.

Mësimi në distancë nuk do të ishte i mundur pa angazhimin maksimal të secilit mësime të cilat janë në komunikim në baza ditore nga **MASHTI**, **DKA** e Prishtinë s dhe Prizrenit që janë angazhuar drejtpërdrejt në përgatitjen e materialit mësimit virtual duke punuar çdo ditë në shkollën "Qamil Batalli" në Prishtinë dhe në shkollën "Emin Duraku" në Prizren.

Mësimi në distancë nuk do të ishte i mundur pa angazhimin maksimal të secilit mësime të cilat janë në komunikim në baza ditore nga **MASHTI**, **DKA** e Prishtinë s dhe Prizrenit që janë angazhuar drejtpërdrejt në përgatitjen e materialit mësimit virtual duke punuar çdo ditë në shkollën "Qamil Batalli" në Prishtinë dhe në shkollën "Emin Duraku" në Prizren.

Raportet që **MASHTI** ka pranuar nga universitetet publike e private, tregojnë se mësimi në distancë po zhvillohet në mënyrën më të mirë të mundshme, falë angazhimit maksimal të profesorëve dhe stafit tjetër mbështetës.

I gjithë mësimi në distancë nuk do të ishte i mundur pa pjesëmarrjen e nxënësve, studentëve, prindërve të cilët e kanë një rol thelbësor në këtë kohë.

Komunat, përmes **DKA**-vë, po ndihmojnë shumë në koordinim dhe mbarëvajtje të mësimit në distancë.

Mbështetësit e pakursyer sikurse: **OJQ TOKA**, **ASHI**, Kallxo, **RTK**, LinkPlus, **GIZ**, **Banka Botërore** dhe shumë vullnetarë të tjerë.

Gjithashtu Kabineti i MASHTI-t, duke përfshirë zëvendësministrin Jusuf Thaçi, zëvendësministrin Xhavit Rexhaj dhe zëvendësministrin Enis Kervan këshilltarët: Lulzim Krasniqi, Ermal Lubishtani dhe Merlinda Ramaj.

Ky ekip prej mijëra vetave është mobilizuar të zhvillojë arsim në distancë, e ky mobilizim në arsim na e kujton mobilizimin në vitet e 90-ta.

Uroj që së shpejti t'i kthehemi normalitetit, por gjithashtu besoj që mësimi në distancë nuk do të jetë vetëm për ditë të vështira si kjo, por besoj që ky projekt do jetë themeli i një projekti të madh të digitalizimit në fushën e arsimit.

Ju faleminderit të gjithëve dhe qofshi me shëndet!